



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 1867 Prot.

Tiranë, më 9 . 3 . 2020

URDHËR

Nr. 91 , datë 9 . 03 . 2020

PËR

**NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR NË TË GJITHA INSTITUCIONET
ARSIMORE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike për një periudhë 2 (dy) javore, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, sipas urdhrit të Ministrit të MSHMS nr.135, datë 09.03.2020.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

BESA SHAHINI

